



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONERI PËR MBIKËQYRJEN E SHËRBIMIT CIVIL

Nr. 175/1 Prot.

Tiranë, më 17.05.2022

V E N D I M

Nr.68, Datë 17.05.2022

**PËR MIRATIMIN E RAPORTIT PËRFUNDIMTAR TË MBIKËQYRJES
TEMATIKE NË LIDHJE ME ZBATIMIN E LIGJIT NË ADMINISTRIMIN E
SHËRBIMIT CIVIL NË DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË TATIMEVE
INSTITUCION NË VARËSI TË MINISTRISË TË FINANCAVE DHE
EKONOMISË DHE DEPARTAMENTIN E ADMINISTRATËS PUBLIKE**

Në mbështetje të kompetencave ligjore të parashikuara në nenin 11 pika 1, 14 dhe 15 të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, të ligjit nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”, si dhe të Rregullores, “Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, pas shqyrtimit të materialit dhe mendimit paraprak të Drejtorisë të Përgjithshme të Inspektimit dhe Mbikëqyrjes, në lidhje me mbikëqyrjen e zhvilluar në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, institucion në varësi të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentin e Administratës Publike,

VËREJ SE:

Me vendimin nr. 66, datë 17.7.2020, “Për kryerjen e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil, në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve, në varësi të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentin e Administratës Publike”, Komisioneri për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, ka vendosur fillimin e mbikëqyrjes tematike në lidhje me zbatimin e ligjshmërisë gjatë zhvillimit të procedurave për transferimin e përhershëm të nëpunësve civilë duke vlerësuar respektimin e kërkesave të ligjit nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar, në institucionin Drejtorie e Përgjithshme e Tatimeve.

Administrata Tatimore Qendrore (ATQ), e cila përbën autoritetin tatimor në Republikën e Shqipërisë, për zbatimin dhe administrimin e tatimeve kombëtare, pagesave publike dhe mbledhjen e kontributeve, është institucion i administratës shtetërore, në varësi të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë. Krijimi, organizimi dhe funksionimi i Administratës Tatimore Qendrore përcaktohet në ligjin nr. 9920, datë 19.5.2008, *“Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”*, i ndryshuar. Referuar nenit 19, pika 1, të këtij ligji, marrëdhëniet e punës të nëpunësve të administratës tatimore rregullohen sipas dispozitave të legjislacionit për nëpunësin civil, përveç rasteve ku në këtë ligj parashikohet ndryshe.

Objekti i mbikëqyrjes është tematik dhe përfshin veprimet administrative të kryera nga njësia e burimeve njerëzore e Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve, Komisioni i ristrukturimit dhe Departamenti i Administratës Publike gjatë realizimit të procedurave të transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë si rrjedhojë e ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore.

Procesi i mbikëqyrjes në këtë institucion filloi kryesisht në datën 20.7.2020, në zbatim të Programit të Mbikëqyrjes nr. 636/2, datë 17.7.2020, miratuar nga Komisioneri dhe me shkresën nr. 636/3, datë 17.7.2020, *“Njoftim për fillimin e procesit të mbikëqyrjes tematike të ligjshmërisë në administrimin e shërbimit civil, në institucionin Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve”*, i është njoftuar Administratës Tatimore Qendrore.

Në përfundim të procesit të këqyrjes së akteve dhe administrimit të dokumentacionit të nevojshëm, grupi i punës i përbërë nga inspektorët Aida Dobjani, Behare Hoxha dhe Irma Vani, nën drejtimin e Drejtorit të Mbikëqyrjes, Altin Shumeli, përpunoi të dhënat dhe përgatiti projektraportin e mbikëqyrjes në lidhje me administrimin e shërbimit civil në këtë institucion.

Me shkresën nr. 1158/1 prot., datë 30.12.2021 të Komisionerit, projektraporti i hartuar nga grupi i punës, i është dërguar për njohje Drejtorit të Përgjithshëm të Tatimeve, duke i lënë 30 ditë kohë për të paraqitur observacionet.

Me shkresën nr. 1158 prot., datë 30.12.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Administratën Tatimore Qendrore, në lidhje me administrimin e shërbimit civil gjatë procedurës së ristrukturimit”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë, që është ministria nga e cila varet institucioni i mbikëqyrur.

Me shkresën nr. 1158/2 prot., datë 30.12.2021, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil, *“Dërgohet projektraporti në përfundim të mbikëqyrjes në Administratën Tatimore Qendrore, në lidhje me administrimin e shërbimit civil gjatë procedurës së ristrukturimit”*, projektraporti i mbikëqyrjes i është dërguar për njohje edhe Departamentit të Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse për institucionin e mbikëqyrur.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes, Komisioneri ka evidentuar disa problematika gjatë zbatimit të ligjit, të cilat konsistojnë si më poshtë:

- Në momentin e ristrukturimit nuk kanë qenë të miratuara përkrahjet e punës për 6 pozicionet e Drejtorisë të Financës dhe Buxhetit, pranë Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve.

Ky fakt është vlerësuar si parregullsi në administrimin e shërbimit civil gjatë procesit të transferimit të nëpunësve civilë për shkak të mbylljes apo ristrukturimit të institucionit, pasi ligji specifik që rregullon këtë aspekt, kërkon që procesi i hartimit të përkrahjeve të punës duhet të përfundojë për të gjitha pozicionet e punës, përpara se të fillojë procesi i ristrukturimit, pavarësisht faktit se në këtë rast janë evidentuar kriteret dhe kërkesat specifike për këto pozicione pune.

Në këtë rast njësi përgjegjëse për menaxhimin e burimeve njerëzore duhet të finalizojë procesin e miratimit të përkrahjeve të punës dhe në përfundim të tij një kopje e aktit të nënshkruar të bëhet pjesë e dosjes së personelit të çdo nëpunësi civil, një kopje të depozitohet në arkivin e institucionit dhe një kopje të depozitohet pranë Departamentit të Administratës Publike.

- Në përmbajtjen e aktit nr. 10945/1 prot., datë 01.7.2020, “*Vendim i Komisionit të Ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore, për propozimin e transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë në kuadër të ristrukturimit*”, janë analizuar vetëm ndryshimet strukturore dhe nuk ka asnjë akt tjetër administrativ, ku Komisioni i Ristrukturimit të ketë analizuar kriteret kyç që kanë shërbyer për vlerësimin dhe krahasimin e nëpunësve civilë që plotësojnë kushtet përkundrejt pozicionit për të cilin po gjykohet.

Gjatë procesit të mbikëqyrjes u vu re se, në vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit nuk është treguar kujdes që të vlerësohen dhe krahasohen nëpunësit sipas Metodologjisë së Vlerësimit dhe Sistemit të Pikëzimit, me qëllim zbatimin e parimit të meritokracisë për të evidentuar nëpunësit civilë me më tepër pikë, në kuadër të transferimit të tyre të përhershëm.

Në disa raste, Komisioni i Ristrukturimit ka propozuar transferimin e nëpunësve civilë, në kundërshtim me legjislacionin e shërbimit civil, pasi nuk ka kryer një analizë të hollësishme për ndryshimet që kanë pësuar pozicionet ku këta nëpunës kanë qenë të emëruar.

Departamenti i Administratës Publike, në cilësinë e njësisë përgjegjëse duhet të tregojë kujdes në të ardhmen, duke orientuar, udhëzuar dhe trajnuar anëtarët e Komisionit të Ristrukturimit, me qëllim marrjen e një vendimi të arsyetuar, të argumentuar dhe të mbështetur në dokumentacionin shkresor të procedurës së ristrukturimit. Procedura e ristrukturimit duhet të administrohet, duke

materializuar çdo etapë dhe element procedural nëpërmjet përpilimit të akteve përkatëse administrative.

- Komisioni i Ristrukturimit në **10** raste ka propozuar transferimin e nëpunësve civilë në pozicione pune të së njëjtës kategori, por me klasë page më të ulët. Ndërsa në **2** (dy) raste, komisioni ka propozuar transferimin e përhershëm në një pozicion të shërbimit civil, jo të së njëjtës kategori.

Me qëllim zbatimin dhe respektimin e parimeve të administrimit të shërbimit civil, njësia përgjegjëse (DAP) duhet të unifikojë qëndrimin, duke vlerësuar dhe praktikën gjyqësore, në lidhje me transferimet e përhershme brenda të njëjtës kategori pozicioni dhe klasë page.

Njësia përgjegjëse duhet të marrë masa dhe të garantojë trajtimin e barabartë të nëpunësve civilë, nëpërmjet përdorimit të praktikave të unifikuara, me qëllim respektimin e një prej parimeve themelore të shërbimit civil, atë të mosdiskriminimit.

- Gjatë njoftimit të akteve individuale të transferimit për nëpunësit e drejtorive rajonale, njësia e burimeve njerëzore duhet të kishte siguruar kryerjen e këtij njoftimi brenda afateve ligjore, marrjen e mendimit me shkrim dhe dërgimin e këtyre akteve pranë njësisë përgjegjëse.
- Në përditësimin dhe plotësimin e dosjeve të personelit me dokumentacionin e nevojshëm për vendimmarrjen e Komisionit të Ristrukturimit, njësia e burimeve njerëzore duhet të kishte kërkuar nga nëpunësit civilë përditësimin e të dhënave në lidhje me vendbanimin ose gjendjen e tyre shëndetësore, me qëllim shmangien e zvarritjes së procedurës së ristrukturimit.
- Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse nuk kanë mbajtur një qëndrim të unifikuar, në rastin kur argumentohet tejkalimi i afateve të shqyrtimit të shkaqeve të refuzimit nga Komisioni i Ristrukturimit, për shkak të gjykimit të mosmarrëveshjes administrative në organet gjyqësore. Komisioni i Ristrukturimit dhe njësia përgjegjëse kanë vijuar me verifikimin e shkaqeve të refuzimit, pavarësisht ankimit të paraqitur nga nëpunësi civil në gjykatën kompetente, *(rastet e nëpunësve ***** , ***** , ***** dhe të tjerë)*.
- Procedura e transferimit të përhershëm në kuadër të ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore nuk është realizuar brenda afateve ligjore, duke përmbyllur këtë proces me zvarritje, pasi rezultoi që ai të ketë nisur në datën 12.2.2020 *(me miratimin e strukturës së re me urdhrin nr. 33, datë 12.2.2020, të Kryeministrit)* dhe ka përfunduar në datën 8.3.2021 *(me vendimin nr. 10945/6 prot., datë 8.3.2021, të Komisionit të Ristrukturimit)*.

Komisioneri vlerëson rrethanat specifike të këtij procesi me një numër të lartë të punonjësve që duhet të trajtoheshin nga Komisioni i Ristrukturimit dhe njësi përgjegjëse si dhe realizimin e tij gjatë periudhës së pandemisë Covid - 19, duke kërkuar nga Departamenti i Administratës Publike, që në të ardhmen, të tregojë kujdes, duke orientuar dhe bashkëpunuar me Komisionin e Ristrukturimit dhe njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të institucionit, me qëllim realizimin dhe përfundimin e të gjitha etapave të procedurës së ristrukturimit në përputhje me afatet ligjore, me qëllim që të mos shkaktohen zvarritje të procesit dhe për pasojë edhe probleme me efikasitetin e burimeve njerëzore.

- Njësia përgjegjëse të tregojë kujdes në unifikimin e praktikave ligjore të zbatuara gjatë procesit të ristrukturimit të institucionit, si në aspektin material, ashtu edhe procedural.
- Në lidhje me njësinë e menaxhimit të burimeve njerëzore të Administratës Tatimore Qendrore, kërkohet që në të ardhmen të garantojë ligjshmërinë e procedurave duke përdorur të gjitha mjetet ligjore që ligji i njej në rast të mospërbushjes së detyrimeve nga personat përgjegjës për një proces ligjor të caktuar, ashtu si është edhe ristrukturimi i institucionit.

Njësia e menaxhimit të burimeve njerëzore në ATQ, duhet të rrisë dhe të forcojë bashkëpunimin me njësinë përgjegjëse, Departamentin e Administratës Publike dhe të dy institucionet të mos mjaftohen vetëm me aspektin e komunikimit shkresor midis tyre.

Subjekti i mbikëqyrur pasi është njohur me projektraportin dhe gjetjet e grupit të punës, me shkresën nr. 124/1 prot., dt. 4.2.2022, *“Përcjellje të projektraportit nr. 1158/1 prot., datë 30.12.2021, protokolluar me tonën nr. 124 prot., datë 7.1.2022 dhe sqarime”*, ka dërguar të nënshkruar projektraportin së bashku me disa sqarime në lidhje me hartimin dhe miratimin e përshkrimeve të punës për Drejtorinë e Proceseve të Biznesit; njoftimin e akteve të transferimit të përhershëm për shkak të ristrukturimit të institucionit nëpunësve përkatës; si dhe, bashkëpunimin me njësinë përgjegjëse DAP gjatë realizimit të procesit të ristrukturimit duke mos paraqitur vërejtje lidhur me gjetjet e trajtuara në pjesët respektive të projektraportit.

Njësia përgjegjëse DAP, me shkresën nr. 63/1 prot., datë 17.2.2022 *“Kthim përgjigje suajës nr. 1158/2 prot., datë 30.12.2021”*, ka dërguar disa sqarime të hollësishme në lidhje me tërësinë e veprimeve administrative të kryera në kuadër të ristrukturimit të personelit të Administratës Tatimore Qendrore siç janë: Krijimi i Komisionit të Ristrukturimit; një analizë të detajuar krahasuese mbi mënyrën e ndërtimit të strukturës së re dhe strukturës ekzistuese të Drejtorisë të Përgjithshme të Tatimeve, Drejtorisë të Tatimpaguesve të Mëdhenj dhe 13 drejtorive rajonale; njësitë organizative që kanë ndryshuar, që janë krijuar rishtazi apo që janë suprimuar; pozicionet e punës që janë prekur nga ristrukturimi, ato që janë krijuar apo janë shkurtuar/suprimuar; propozimin e Komisionit të Ristrukturimit për transferimin e nëpunësve civilë në një pozicion tjetër të

shërbimit civil, të së njëjtës kategori; vendimin e njësisë përgjegjëse për transferimin e çdo nëpunësi civil dhe njoftimin e nëpunësit për vendimin duke marrë edhe mendimin e tij me shkrim; shqyrtimin nga njësia përgjegjëse të ankesave të paraqitura nga nëpunësit që e kanë refuzuar vendimin e transferimit për shkak të ristrukturimit si dhe respektimin e afateve procedurale brenda të cilave duhet të përmbyllej i gjithë procesi për sistemimin e punonjësve në strukturën e re.

Lidhur me gjetjet e grupit të punës të trajtuara në pjesët respektive të projektraportit njësia përgjegjëse nuk ka paraqitur vërejtje. Sqarimet e dërguara nga njësia përgjegjëse, janë administruar në dosjen e mbikëqyrjes dhe janë trajtuar në pjesët përkatëse të raportit përfundimtar.

Sa më sipër, çmoj se janë kryer të gjitha procedurat e nevojshme që sigurojnë transparencën e procesit dhe mundësinë e institucionit të kontrolluar dhe njësisë përgjegjëse për të shprehur pretendimet e tyre në lidhje me problematikën e evidentuar.

Në këto rrethana, pasi shqyrtova raportin përfundimtar të mbikëqyrjes, të paraqitur për miratim nga grupi i punës, vlerësoj se duhet të miratoj përmbajtjen e tij.

Për këto arsye:

Në mbështetje të kompetencave ligjore të përcaktuara në nenin 11, pika 1, nenet 14 dhe 15, të ligjit nr. 152/2013, *“Për nëpunësin civil”*, i ndryshuar, referuar Seksionit III, *“Procedura hetimore”*, të ligjit nr. 44/2015, *“Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë”*, si dhe Rregullores *“Mbi procedurat e mbikëqyrjes/inspektimit”*, miratuar me vendimin nr. 17, datë 11.3.2015, të Komisionerit për Mbikëqyrjen e Shërbimit Civil,

V E N D O S A:

1. Të miratoj përmbajtjen e raportit përfundimtar të mbikëqyrjes, në lidhje me zbatimin e ligjit në administrimin e shërbimit civil në Drejtorinë e Përgjithshme të Tatimeve institucion në varësi të Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Departamentin e Administratës Publike gjatë realizimit të procedurave të transferimit të përhershëm të nëpunësve civilë si rrjedhojë e ristrukturimit të Administratës Tatimore Qendrore, i cili do të jetë pjesë e këtij vendimi dhe përfundimin e procesit të mbikëqyrjes, pasi problemet e evidentuara nuk janë të natyrës që prekin thelbin e procedurave administrative të kryera gjatë administrimit të shërbimit civil. Për këtë arsye, ky proces nuk do të shoqërohet me një vendim paralajmërimi por, problematikat e ngritura do të mbahen në vëmendje të Komisionerit për të ardhmen, duke kërkuar informacion për aspekte të ndryshme të diskutuara në këtë raport.
2. Për këtë vendim të njoftohen Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Departamenti i Administratës Publike, duke iu dërguar një kopje të raportit

përfundimtar të mbikëqyrjes dhe njëkohësisht, të informohet Sekretari i Përgjithshëm i Ministrisë të Financave dhe Ekonomisë dhe Komisioni për Çështjet Ligjore, Administratën Publike dhe të Drejtat e Njeriut në Kuvendin e Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONERI

Pranvera STRAKOSHA